VENDIM
Nr. 227, datë 14.4.2021

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË KRYEMINISTRISË, TË PRONËS ME EMËRTIMIN "GODINA E KRYEMINISTRISË", NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8160, DHE PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 968, DATË 25.10.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Kryeministrisë të pronës me emërtimin "Godina e Kryeministrisë", ndodhur në zonën kadastrale 8160, sipas formularit dhe planrilevimit bashkëlidhur këtij vendimi, për ushtrimin e aktivitetit administrativ.
2. Vendimi nr. 968, datë 25.10.2013, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Financave te Kryeministria, të pronës nr. 1/16, në zonën kadastrale ZK 8160, me emërtimin 'Godinë e Ministrisë së Financave', me vendndodhje në bulevardin 'Dëshmorët e Kombit', nr. 1, Tiranë, për sistemimin me mjedise pune të Kryeministrisë dhe për një ndryshim në vendimin nr. 622, datë 15.9.2006, të Këshillit të Ministrave, 'Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Financave'", shfuqizohet.
3. Ngarkohen Kryeministria dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe




Plan Rilevimi Kryeministria.pdf - Adobe Acrobat Pro
File Edit View Window Help
Create
Customize
Tools
Sign
Comment
PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
PRONARI _SHTET
DATE _29.01.2021
QELLIMI _RREGJISTRIM
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE
SH 1:1000
Activate Windows
Go to Settings to activate Windows.
Type here to search
3:12 PM
4/15/2021